



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS

Nr. 2033 Prot

Vlorë, më: 18.12 2024

PROCESVERBAL

KONSULTIM ME PUBLIKUN PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE
VENDORE PËR VITIN 2024 NË BASHKINË VLORË

Data: 16.12.2024 ora 17.00
Vendi: Pallati i Kulturës "Labëria"

Baza ligjore: Ligji nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" neni 18; ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligji nr.146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullorja e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë, Urdhri i Brendshëm nr.147 datë 09.06.2022 "Për caktimin e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të Bashkisë Vlorë"

Marrin pjesë: Znj.Elpinqi Mërkuri- Kryetare e Këshillit Bashkiak, Znj.Irena Toshkallari-Nënkryetare e Bashkisë Vlorë, znj.Anjeza Shiko-Drejtoare e DAV, përfaqësues nga administrata e bashkisë dhe media lokale.

Takimin e hapi znj. Elpinqi Mërkuri, kryetarja e Këshillit Bashkiak: Përshëndetje. Po organizojmë degjese me kërkesë të kryetarit të bashkisë i cili është drejtuar këshillit bashkiak për projektvendim, për zhvillimin e një mbledhje jashtë radhe në datë 18 për disa ndryshime. Pikat e projektvendimit ishin për paketën fiskale i cili është detyrim ligjor të kaloj me konsultim përpara miratimit në këshill të buxhetit për vitin 2025. Ky projektvendim është me disa ndryshime për të cilin do ja japim fjalën drejtoreshës përkatëse për të bërë referimet dhe ndryshimet për të cilat bizneset apo të interesuarit duhet të sjellin rekomandimet deri ditën e nesërme.

Znj.Irena Toshkallari: Presim propozimet si nismë e kërkuar nga një pjesë e këshilltarëve. Një pjesë e rëndësishme për paketën fiskale janë lehtësirat për studentët. Falë nismës së kryetarit të bashkisë dhe nënshkrimit të marveshjes me ministrinë e arsimit, studentët e Universitetit të

Vlorës do të kenë disa incentive lehtësuese me tarifa të reduktuara deri në 50% për biletat e teatrit, biletat e galerisë, ne pallatine e kulturës apo shërbime të tjera kulturore që ofrohen në Bashkinë e Vlorës. Është një nismë e drejtëpërdrejtë e kryetarit për studentët e qytetit të Vlorës. Propozimet lehtësuese vijnë edhe nga një grup këshilltarësh.

Znj.Anjeza Shiko. Pas analizës së kërkesës së këshilltarëve drejtuar administratës së bashkisë e cila ka pranuar propozimet, të cilat janë në favor të biznesit. Ndryshimet dhe saktësimet

Për subjektet që kanë seline kryesore jashtë territorit të Bashkisë Vlorë dhe që ushtrojnë aktivitete me adresë dytësore në këtë territor, vlerësimi tatimor të kryhet në bazë të xhiros vjetore të deklaruar dhe vërtetuar me dokumentin nga DRT.

Subjektet që kanë selinë e kryesore në territorin e Bashkisë Vlorë dhe ushtrojnë aktivitete edhe në adresa të tjera, vlerësimi tatimor do të kryhet në bazë të xhiros vjetore të deklaruar nga tatimpaguesit dhe vërtetuar me dokument nga DRT.

Sic mund të jetë aktiviteti në rajonin 1 e adresa dytësor në rajon tjetër.

Janë shtuar ndryshimet për dy aktivitete që nuk i kemi patur. Për zënie të hapsirës publike për subjektet që ushtrojnë veprimtari tregtare ATM dhe karikuesit e pajisjeve elektronike dhe mjete elektrike në vlerën 1000 lekë.

Tarifat e studentëve me tarifa të reduktuara sic u tha dhe më para. Këto janë të vetmet ndryshimet që i shtohen paketës fiskale. Të tjerat do të jenë sipas VKB të miratuar në 12.06.2023 me propozimet e sjella nga bashkia do të miratohen në mbledhjen e këshillit bashkiak.

Elpiniqi Mërkuri: Presim sygjerimet që do të keni në mënyrë që të sjellim më të mirën për të gjithë banorët e qytetit.

Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Albana Naçi